



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

**A nr. 445/ 2010**

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga, Muharrem Shala kryesues, Xhevdet Abazi dhe Nehat Idrizi, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosja (LVV) me seli në Prishtinë, paraqitur kundër Komisionit Qendror Zgjedhor (KQZ) me seli në Prishtinë, për shkak se ka munguar libra e evidencës për ankesa, në seancën e panelit të mbajtur me 13.12.2010, mori këtë:

## **V E N D I M**

**Hidhet** poshtë ankesa si e palejuar e subjektit politik, Lëvizja Vetëvendosja (LVV).

## **A r s y e t i m**

PZAP ka pranuar një ankesë më datë 12.12.2010, nga subjekti politik LVV, me te cilën pretendohet më datë 12.12.2010 në shkollën fillore “Ditët e Minatorit” në Kishnicë QV 1938E se ka munguar libra e evidencës së ankesave, siç thekson parashtruesi i ankesës në këtë rast është bërë shkelje e nenit 4 paragrafi 2 pika i rregullës zgjedhore nr. 09/2009 (a) e LZP-së.

Parashtruesi i ankesës nuk ka bashkangjitur asnjë provë. Me propozim që të anulohet votimi në QV 1938E.

Neni 59 paragrafi 2 i LZP-së, parasheh:

*59.2 KQZ-ja e Kosovës siguron përgatitjen dhe mbajtjen e zgjedhjeve në pajtim me parimet dhe kërkesat e këtij ligji.*

## **Përgjegjësit dhe Funkcionet e KQZ-së**

Neni 64 i LZP-së parasheh:

*64.1 KQZ-ja është përgjegjëse për zbatimin e këtij ligji*

Rregullat dhe Procedurat e PZAP-it, neni 6 paragrafi 4 parasheh:

*Panelet vendim-marrëse mund ta refuzojnë me procedurë të shpejtë ankesën apo një grumbull ankesash, të cilat nuk janë në përputhje me dispozitat e duhura ligjore apo ato të cilat sipas mendimit të tyre nuk paraqesin një rast prima facie .*

PZAP-i pasi që shqyrtoj dhe analizoi shkresat e lëndës gjeti se;

**- ankesa është e palejuar.**

Pretendimet nga parashtruesi i ankesës, se janë bërë shkeljet e theksuara në ankesë nuk janë nën juridiksionin e PZAP-it, duke u bazuar në arsyet e cekuar më lartë e po ashtu në pajtim me dispozitat e cituara ligjore, në kuptim të nenit 115 paragrafi 1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoba e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia**

A nr. 445/2010 më datën 13.12.2010.

